



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

KRYETARI

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 4305 datë 18.08 2022

**“PËR MIRATIMIN E MARREVËSHJES  
DHE PJESMARRJEN E BASHKISË LEZHË NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA  
TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT  
ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË  
UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave 302 datë 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”, Marreveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizimeve date 22.07.2022 lidhur ndermjet Bashkise Lezhë dhe MIE dhe Bashkive Kurbin dhe Mirditë , Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.56, datë 13.06.2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e sherbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura”, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Lezhë,

**PËR TË VENDOSUR:**

1. Miratimin e Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizimeve datë 22.07.2022 lidhur ndermjet Bashkisë Lezhë dhe MIE dhe Bashkive Kurbin dhe Mirditë.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë z.Pjerin Ndreu në cilësinë e tij si aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Lezhë”, UK, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizimeve datë 22.07.2022, që pas krijimit të Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vij të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare UK “Ujësjetllës-Kanalizimeve Sh.a Lezhë” z.Zef Maçi për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe notarial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka, për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR**

**Pjerin NDREU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Lezhë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**Lënda:** Relacion për projektvendimin: “Për miratimin e marrevëshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”

### KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

LEZHË

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit, dhe të përpunimit të ujërave të ndotura”, Shkresës nr.950, datë 28.01.2022 të Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë me lëndë “ Mbi reformen në sektorin e ujësjellës kanalizimeve”, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.56, datë 13.06. 2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, Kryetari i Bashkisë i ka paraqitur Këshillit të Bashkisë Lezhë projektvendimin: “Për miratimin e marrevëshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.56, datë 13.06. 2022 “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka vendosur:

- 1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjellës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.*
- 2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si përfaqësues i Aksionar i vetëm i Shoqërisë Aksionare Ujësjellës-Kanalizime Lezhë, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jete aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë*

*Aksionare Ujësjellës-Kanalizime Lezhë për nënshkrimin e çdo akti te nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit te veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK qe do te krijohet.*

Në zbatim të vendimit të sipërcituar të Këshillit të Bashkisë Lezhë, Kryetari i Bashkisë Lezhë në cilësinë e përfaqësuesit të bashkisë me datë 22.07.2022 ka lidhur marrëveshjen “Për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizimeve”, me Bashkinë Kurbin, Bashkinë Mirditë dhe Ministrinë e Infrastrukturas dhe Energjise.

Qëllimi i marrëveshjes është krijimi i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizimeve SKP-UK, i cili do të kryejë veprimtarine e furnizimit me ujë dhe largimit, grumbullimit dhe trajtimitin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin të cilat janë palë në marrëveshjen e paraqitur për miratim, pjesë e të cilës është dhe AKUM-i.

Sipas marreveshjes pjesmarrja në përqindje në Asamblenë e Aksionereve në Shoqërine e e re SKP-UK është si më poshtë:

|  |         |
|--|---------|
| 1. Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë | 51 %    |
| 2. Bashkia Lezhë                             | 30.71 % |
| 3. Bashkia Kurbin                            | 12.41 % |
| 4. Bashkia Mirditë                           | 5.87 %  |

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore; i ndryshuar:

Neni 2, pika 11 përcakton se: “*Subjekt i kompetencave të përbashkëta*” është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët”.

Neni 14,

1. *Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.*

2. *Në çdo marrëveshje të bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen:*

- a) qëllimi i marrëveshjes;*
- b) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki apo në mënyrë të përbashkët;*
- c) mënyra me anë të së cilës do të plotësohet qëllimi;*
- c) shkalla dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave;*
- d) mënyra dhe masa e kontributit financiar përkatës dhe e ndarjes së të ardhurave e të përfitimeve të tjera.*

3. ***Marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor miratohet nga këshillat përkatës të secilës prej njësisive të vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje. Detyrimi financiar për secilën prej njësisive të vetëqeverisjes vendore, palë të marrëveshjes, miratohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin vendor.***

4. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë marrin mendimin e Ministrisë Punëve të Jashtme.*

5. *Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët*

*për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.*

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit, dhe të përpunimit të ujrave të ndotura”, Kreu II, pikat 1 dhe 2 përcaktojnë se:

*1. Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.*

*2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas formatit tip të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

Për arsyet e sipërcituara Bashkia Lezhë ka paraqitur për miratim projektvendimin “Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”

Bashkëlidhur,

1. Kopje e marrëveshjes së nënshkruar të datës 22.07.2022

**KRYETARI**  
**Pjerin Ndreu**



**PËR DREJTORINË JURIDIKE**  
**DREJTORI**  
**DENIS FRROKU**



Nr. 3296 Prot  
Dt. 25.07.22



## MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë 22.07.2022 ndërmjet:

Bashkisë Lezhë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Pjerin Ndreu,

Bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Ndrec Dedaj,

Bashkisë Kurbin, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Znj. Majlinda Cara

dhe

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu e me poshtë referuar si MIE) përfaqësuar nga Ministrija e Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Belinda Balluku,

këtej e tutje referuar të gjitha si “Palët”.

*Meqënëse:*

- Duke pasur parasysh reformën e ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve;
- Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane;
- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve Lezhë, Mirditë dhe Kurbin vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin e administrimit të aseteve të saj, shëndoshjen e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e tyre të shërbimit;
- Në mbështetje të VKM Nr.302 datë 11.05.2022 që autorizon MIE për hyrjen në një marrëveshje specifike me Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkisë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;
- Në mbështetje të Vendimit Nr.56 datë 13.06.2022 të Këshillit Bashkiak Lezhë, Vendimit Nr.32 datë 31.05.2022 të Këshillit Bashkiak Mirditë dhe Vendimit Nr.54 datë 27.06.2022 të Këshillit Bashkiak Kurbin që autorizojnë Kryetarët e Bashkive të hyjnë në një

marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.

Palët bien dakort të hyjnë në një marrëveshje me kushtet dhe termat e mëposhtëm:

### Neni 1 Baza Ligjore

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:
  - a) Dispozitat e pikës 5 të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar;
  - b) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;
  - c) Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
  - d) VKM-në Nr. 302 datë 11.05.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

### Neni 2 Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës - Kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM.

### Neni 3 Forma dhe emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta

1. Palët bien dakort që Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizimeve do të jetë një shoqëri aksionare e krijuar SKP-UK, tek e cila do të transferohet tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjetës-kanalizimeve të cilat aktualisht janë në pronësi të Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.
2. Emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta i krijuar sipas kësaj marrëveshjeje do të jetë Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Lezhë sh.a.
3. Shoqëria aksionare e krijuar sipas kësaj marrëveshjeje do të administrohet me dy nivele administrimi. Organet drejtuese të shoqërisë do të krijohen dhe kompozohen sipas

dispozitive të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar.

4. Shoqëria do të ketë si statut të saj statutin tip të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 4

##### Objekti i SKPUK

1. Objekti i SKPUK-së është kryerja e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë.
2. Shoqëria e re e krijuar mund të ngarkohet me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të bashkive palë në këtë marrëveshje, nëse kjo kërkohet prej tyre.

#### Neni 5

##### Afati i SKPUK

Palët bien dakort që SKPUK i krijuar sipas kësaj marrëveshje të krijohet për një periudhë të pacaktuar.

#### Neni 6

##### Kontributi i Palëve

1. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a, është në masën 10.000.000 lekë. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likujdojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.
2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionerëve në shoqërinë e re ujësjellës - kanalizime (SKPUK) e Bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, në pronësi të të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, është përlllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave do të përbejë 49% të aksioneve të shoqërisë së re dhe përbëhet në përqindje si vijon: Bashkia Lezhë 30.71%, Bashkia Mirditë 5.87% dhe Bashkia Kurbin 12.41%.
3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të

- ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
4. Në Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, brenda datës 31 dhjetor 2022, janë përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a.
  5. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga eksperti kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.
  6. Aksionerët do të nënshkruajnë kontratë rritje kapitali që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen dhe të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas kësaj marrëveshje.
  7. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a.
  8. Në rastet kur vlera e investimit të parashikuar dhe marrë tashmë përsipër nga qeveria qendrore dhe të pasqyruar në tavanet buxhetore do të kalojë vlerën nominale të 51% të aksioneve, pasqyrimi i vlerës së tepricës nuk ndryshon masën e pjesëmarrjes në aksione të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë sh.a.
  9. Gjithashtu, si instrument për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, do të konsiderohet edhe shuarja me kompensim e vlerës së detyrimeve që UK Lezhë sh.a, UK Mirditë sh.a dhe UK Kurbin sh.a kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-UK, ndaj institucioneve qendrore buxhetore dhe jo buxhetore, deri në masën e pagimit të plotë të 51% të aksioneve të shoqërisë së re.

#### Neni 7

##### Procedurat e Transferimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive UK Lezhë sh.a, UK Mirditë sh.a dhe UK Kurbin sh.a me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), do të caktojnë ekspertë të pavarur për të vlerësuar dhe asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK.
2. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2021.
3. Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i Drejtorive Tatimore.
4. Veprimtaritë e UK në periudhën nga data e bilancit të transferimit deri në datën e transferimit efektiv do të sjellë si pasojë ndryshimin e balancave të transferimit, të cilat do



të rregullohen me efekt në tepricën e transferimit që do të njihet. Pasqyrat financiare do të hartohen në datën e transferimit efektiv dhe për këtë mund të përgatitet një raport i posaçëm për të identifikuar diferencat dhe rregullimin e tyre.

5. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës së themelimit të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë sh.a, shpenzimet e nevojshme për caktimin e ekspertëve si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë tek shoqëria e re SKP-UK do të përballohen nga buxheti i shtetit. Vlera e shpenzimeve të mësipërme si dhe vlera e shpenzimeve fillestare që do t'i akordohet Shoqërisë Rajonale UK Lezhë sh.a do të përlllogaritet si kontribut në shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të përftuara nga MIE.
6. Shpenzimet për likuidimin e shoqërive transferuese do të përballohen nga shoqëria e re SKP-UK.

#### Neni 8

##### Prishja e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme

1. Asnjë nga palët nuk mund të prishë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa kaluar 10 vjet nga krijimi i SKPUK-së.
2. Pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përcaktuar në pikën 1, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në çdo kohë mund të vendosë tërheqjen e njëanshme nga kjo marrëveshje duke i transferuar aksionet e saj në shoqërinë e krijuar sipas kësaj marrëveshje tek Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin proporcionalisht me përqindjen e aksioneve të tyre në shoqëri.
3. Nëse një nga Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin kërkon prishjen e njëanshme të kësaj marrëveshje pas kalimit të afatit 10-vjeçar, bashkia duhet të ndërmmarrë hapat e kërkuara në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
4. Nëse një nga bashkitë vendos të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas pikës "3", ajo është e detyruar që për vitin buxhetor pasardhës të mbulojë të gjitha investimet apo detyrimet e tjera financiare përfshirë masat e miratuara në biznesplanin e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve.

#### Neni 9

##### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt secila nga palët mund t'i drejtohet për zgjidhjen e saj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10  
Të tjera

Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurat e prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 11  
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e Prefektit/Prefektëve sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.


1. Kryetari i Bashkisë Lezhë



2. Kryetari i Bashkisë Mirditë



3. Kryetari i Bashkisë Kurbin



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

